



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

Ministri Ahmetaj zgjidhet Zv. Kryetar i Bordit të Guvernatorëve të BERZH

2018-05-09 08:24:00



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, z. Arben Ahmetaj ka marrë pjesë sot në Takimin Vjetor të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), i cili po zhvillohet në Jordani. Në fokus të këtij takimi janë investimet e Bankës në vendet ku ajo operon, si dhe perspektiva e zgjerimit në rajonin e Afrikës Sub-Sahariane.

Gjatë punimeve të Takimit Vjetor të Bordit të Guvernatorëve dhe Forumit të Biznesit të Bankës, Ministri Ahmetaj është zgjedhur me anë të votimit Zv.Kryetar i Bordit të Guvernatorëve të BERZH.

Në fjalën e tij gjatë takimit, Ministri Ahmetaj bëri një prezantim të zhvillimeve kryesore ekonomike në Shqipëri dhe reformave kryesore të ndërmarra nga qeveria shqiptare.

Ahmetaj theksoi se “ekonomia shqiptare është në vitin e katërt të përshpejtimit të rritjes në 3.8 %” dhe se “përpjekjet për konsolidim fiskal dhe rritje ekonomike kanë qenë faktorë përcaktues për krijimin e vendeve të punës dhe uljen e pabarazisë”, ndërsa papunësia tek të rinjtë në ekonominë shqiptare është më e ulta në rajon.

Ministri i Financave dhe Ekonomisë shprehu vlerësimin e qeverisë për rolin që Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ka në një sërë projektesh të rëndësishme në vendin tonë, si në infrastrukturë, energji, klimën e biznesit dhe financimin në bujqësi.

Në këtë kuadër, Ministri Ahmetaj tha se investime me mbështetjen e BERZH, si Bypassët e Fierit dhe Vlorës dhe hekurudha Tiranë-Durrës, janë investime tejet të rëndësishme për përmirësimin e infrastrukturës në vend.

Gjatë punimeve të Takimit Vjetor, Ministri Ahmetaj mbështeti propozimin e Bordit të Guvernatorëve të BERZH për të eksploruar mundësitë e shtrirjes në vende të reja në rajonin e Afrikës Sub-Sahariane.